

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALL IT & e”

Sot, më datë 17.1.2021

THEMELUESI:

Vasil Nasti, atësia Jeras, amësia Vasiliqi, shtetas Shqiptar, lindur në Lukovë, Sarandë dhe banues në HIMARË, me adresë: Ndrelat 04400039; Nd. 1; H. 1; Lukovë; Lukovë; 9713; Himarë, lindur më 09/03/1965, gjendja civile “i divorcuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035021968 dhe nr. personal G50309022D.

me cilesine e “ortakut themelues “redaktoj kete akt themelimi, nepermjet te cilit deklaroj se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ne ligjin “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon **Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi të Kufizuar “ALL IT & e” sh.p.k..**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **“ALL IT & e” sh.p.k.**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“ALL IT & e” sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Ortaku i Vetem Vasil Nasti**, i cili mbulon humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, me adresë: Rr."Vaso Pasha", Nr.32, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4



Fq. 1

Objekti i veprimitarise

- Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve te tjera te perpunimit te informacionit;
- Prodhimi i instrumenteve dhe aparatave per matjen dhe kontrollin;
- Tregtia me shumice dhe tregti me porosi; Shitia te tjera pakice ne dyqane jo te specializuara;
- Tregtia me pakice e furnizimeve per zyra dhe kompjutera;
- Tregtia me pakice ne dyqane jo te specializuara;
- Aktivitetete te tjera te lidhura me Teknologjine e Informacionit (IT);
- Perfaqesimi i Shoqerive te huaja;
- Aktiviteti i mbrojtjes personale;
- Projektimi, ndertimi dhe mbikqyrja e ndertimit;
- Mbajtja e Seminareve dhe kurseve;
- Shkollim ne fushen e teknologjise se informacionit;
- Kontabilitet;
- Organizimi i seminareve, kurseve dhe keshillimeve ne fushen e IT dhe informatikes;
- Zhvillimi dhe mirembajtja e faqeve web dhe aplikimet web;
- Konsulence lidhje me biznesin dhe administrimin;
- Sherbime Dixhitale, Marketing (reklamim dhe propaganda);
- Aktiviteti i rrjeteve te komunikimit elektronik dhe sherbimeve ;
- Aktivite te lidhura me (ICT) Infrastrukture Teknologji Informacioni;
- Sherbimet e projektimit grafik; T
- e kryeje cdo biznes dhe te kryeje cdo veprim ne Shqiperi ose jashte saj qe ka nje marredhenie te drejtperdrejte ose te terthorte me objektin e mesiperm te Shoqerise ose qe eshte i nevojshem per promovimin e biznesit te Shoqerise dhe objektivat e Shoqerise.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000,00 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga "ortaku i vetem " i shoqerise:

Vasil Nasti, zoterues i 1 kuote, me vlore te per gjithshme 100.000,00 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU

II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z. Pierin Marku, atesia Ded, amesia Varvara, i dtl.03.10.1965, lindur ne Kuçove, Berat dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr."A.Z.Çajupi"; Nd. Pall i ri; H. 12

katesh; ; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjt nepermjet leternjoftimit ID me numer 031940864 dhe numer personal G51003078D, i **emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte riperterite**.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) Të përfaqësojë Shoqërinë përparrë të gjitha Institucioneve Publike dhe çdo pale të tretë në Shqipëri ose jashtë saj.

ç) Të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet në lidhje me Shoqerinë, hapjen dhe/ose mbylljen e llogarive bankare në emër të Shoqerisë në çdo valutë, si dhe të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet e venojshme në lidhje me llogaritë bankare të Shoqerisë dhe për të marrë të gjitha veprimet ligjore që lidhen me to.

d) Të punësojë dhe të shkarkojë stafin.

e) Të caktojë persona të tretë si avokatë, kontabilistë dhe auditorë tatimore për të kryer operacione përfunksionimin normal të Shoqerisë.

f) Të hartojë dhe të nënshkruajë kontrata me palë të treta në kuadër të aktivitetit të Shoqerisë.

g) kujdeset përmbraktuar e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

gj) përgatisti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmbraktuar e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;

h) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

i) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmbraktuar Kombëtar të Regjistrimit;


j) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmbraktuarë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmbraktuarë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuarë,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat përmbraktuarë të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrrethanat me përfjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në



Fq. 4

rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mballet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemclare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i **Shoqerise tregtare "ALL IT & e" sh.p.k.**, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen.

THEMELUESI

Vasil Nasti

Vasil Nasti
Orel